

URDHËR
Nr. 178, datë 30.7.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI DETYRIMET E RAPORTIMIT, NË KUADËR TË MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR”¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 3, të ligjit nr. 8/2018, “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit”; të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare””,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Mbi detyrimet e raportimit, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohen Autoriteti Rregullator Hekurudhor, administratorët e infrastrukturës hekurudhore, sipërmarrësit hekurudhorë dhe operatorët e impianteve të shërbimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ky urdhër shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE

“MBI DETYRIMET E RAPORTIMIT NË KUADËR TË MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR”²

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe formatet e të dhënave që i raportohen Komisionit të BE-së (në vijim Komisioni), sipas detyrimeve të informimit, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” (në vijim Kodi), nenin 3, të udhëzimit nr. 15, datë 14.12.2023, “Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve”. Përveç tyre, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

¹ *Kjo rregullore përafron plotësisht, me:*

- Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2015/1100, të 7 korrikut 2015, mbi detyrimet e raportimit të shteteve anëtare, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor, nr. CELEX - 32015R1100, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria OJ L 181, datë 9.7.2015, faqe 1–26.

² *Kjo rregullore përafron plotësisht, me:*

- 32015R1100, Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2015/1100, e 7 korrikut 2015, mbi detyrimet e raportimit të shteteve anëtare në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor.

1. **“Tarifat e përdorimit të infrastrukturës”** (TPI) nënkupton tarifat e mbledhura për paketën minimale të aksesit të përmendur në nenin 32, pika 3, e Kodit;

2. **“Shërbime me shpejtësi të lartë”** nënkupton shërbimet hekurudhore të udhëtarëve të ofruara nga trena me shpejtësi të lartë, duke përfshirë trenat me shpejtësi, që udhëtojnë me të paktën 200 km/orë për të paktën një pjesë të shërbimit; përdorimi i infrastrukturës me shpejtësi të lartë nuk është gjithmonë i nevojshëm;

3. **“Shërbime konvencionale në distanca të gjata”** nënkupton shërbime të transportit hekurudhor të udhëtarëve, përveç shërbimeve urbane, periferike, rajonale ose me shpejtësi të lartë;

4. **“Stacion”** nënkupton një vendndodhje në hekurudhë ku mund të fillojë, ndalojë ose mbarojë një shërbim treni udhëtarësh;

5. **“Terminal mallrash”** nënkupton një vend i pajisur për transferimin e ngarkesës nga një mënyrë transporti në një tjetër, si dhe ruajtjen e njësive të transportit intermodal, ku të paktën një nga mënyrat e transportit është hekurudhor;

6. **“Kompensim total nga shteti”** në kontekstin e marrëveshjeve kontraktuale nënkupton shumën totale që shteti ka rënë dakord t’i paguajë administratorit të infrastrukturës si financim gjatë gjithë periudhës kontraktuale;

7. **“Autoritet monitorues”** nënkupton Autoritetin Rregullator Hekurudhor (në vijim ARRH-ja) që, sipas legjislacionit në fuqi, monitoron dhe verifikon përputhshmërinë e transportit hekurudhor në linjë me parimet ndërkombëtare;

8. **“Linjë e dedikuar me shpejtësi të lartë”** nënkupton një linjë e ndërtuar posaçërisht për të lejuar trafikun të udhëtojë me shpejtësi, përgjithësisht të barabarta ose më të mëdha se 250 km/orë, në segmentet e saj kryesore; ajo mund të përfshijë segmente lidhëse ku shpejtësitë janë të reduktuara për të marrë parasysh kushtet lokale;

9. **“Nyjë”** nënkupton një pikë e rëndësishme në rrjetin hekurudhor ku bashkohen, kryqëzohen ose degëzohen shume linja hekurudhore;

10. **“Shërbim transporti mallrash vendas”** nënkupton një shërbim mallrash që nuk kalon kufirin shtetëror;

11. **“Ndarje itinerari”** nënkupton një vendim mbi ndarjen e itinerareve individuale të trenit për operacione; ndarja e itinerarit për çdo shërbim treni që operon si pjesë e një shërbimi të rregullt të planifikuar llogaritet si një ndarje e veçantë itinerari;

12. **“Itinerar i planifikuar i trenit”**, nënkupton një itinerar të caktuar sipas rregullave të planifikimit të parashikuara në nenin 45, të Kodit;

13. **“Ndarje e refuzuar e itinerarit”** nënkupton një kërkesë për një itinerar që refuzohet nga administratori i infrastrukturës pas procesit të koordinimit të përcaktuar në nenin 46, pika, të Kodit. Çdo anulim i shërbimit të trenit që operon si pjesë e një shërbimi të rregullt të planifikuar llogaritet si një ndarje itinerari e refuzuar;

14. **“Mirëmbajtje”** nënkupton shpenzime jokapitale që administratori i infrastrukturës kryen me qëllim ruajtjen e gjendjes dhe aftësisë së infrastrukturës ekzistuese;

15. **“Rindërtim”** nënkupton shpenzime kapitale për një punim të madh modifikimi të infrastrukturës që përmirëson performancën e saj të përgjithshme;

16. **“Infrastrukturë e re”** nënkupton shpenzime kapitale për projektet për ndërtimin e instalimeve të reja të infrastrukturës;

17. **“Fondet publike”** në kontekstin e shpenzimeve për infrastrukturën nënkupton fonde të buruara direkt nga grantet e investimeve publike;

18. **“Fonde vetjake”** nënkupton fonde nga të ardhurat e fituara nga administratorët e infrastrukturës ose operatorët e impianteve të shërbimit përmes tarifave të aksesit dhe me mjete të tjera;

19. **“Të ardhura”** nënkupton totali i tarifave të mbledhura nga ofrimi i shërbimeve të transportit hekurudhor gjatë periudhës raportuese; përjashton të ardhura të tjera siç janë të ardhurat nga shërbimi i ushqimit, shërbimet e stacionit dhe shërbimet në bord;

20. **“Trafik hekurudhor në territorin kombëtar”** nënkupton çdo lëvizje e mjeteve hekurudhore brenda kufijve të një vendi, pavarësisht nga vendi në të cilin janë regjistruar mjetet;

21. **“Vonesë”** nënkupton ndryshimi në kohë midis kohës së specifikuar në orarin e një treni dhe kohës aktuale në të cilën ai kalon një vendndodhje specifike në itinerarin e trenit në të cilën regjistrohen të dhënat e udhëtimit;

22. **“Shërbim i anuluar”** nënkupton një tren i anuluar në fazën e operimit për shkak të arsyeve që lidhen me shërbimin hekurudhor, duke përfshirë humbjen e një ndalese të planifikuar nëse një tren ndërron itinerar ose duke zëvendësuar një shërbim hekurudhor me një shërbim rrugor;

23. **“Shpejtësia mesatare e orarit”** nënkupton shpejtësinë e llogaritur duke pjesëtuar gjatësinë totale të një udhëtimi me kohën që pritët të zgjasë udhëtimi sipas orarit;

24. **“Shërbime tregtare”** nënkupton të gjitha shërbimet e udhëtarëve që nuk bien brenda fushëveprimit të shërbimeve të ofruara sipas detyrimeve të shërbimit publik;

25. **“Sipërmarrje kryesore hekurudhore”** nënkuptohet sipërmarrja më e madhe për sa i përket udhëtarëve–km ose ton–km;

26. **“Licencë aktive”** nënkupton një licencë e dhënë një sipërmarrjeje hekurudhore që ka filluar dhe nuk ka ndërprerë veprimtarinë brenda periudhave të përcaktuara në nenin 25, pika 4, të Kodit;

27. **“Licencë pasive”** nënkupton një licencë e dhënë një sipërmarrjeje hekurudhore që nuk ka filluar ose ka ndërprerë veprimtarinë brenda periudhave të përcaktuara me nenin 25, pika 4, të Kodit, dhe licencat që janë pezulluar ose revokuar;

28. **“Tarifë për marrjen e një licence”** nënkupton të gjitha tarifat e ngarkuara nga Autoriteti Licencues Hekurudhor në lidhje me përpunimin e kërkesës;

29. **“Koha për marrjen e një licence”** nënkupton kohëzgjatjen midis datës në të cilën paraqitet një kërkesë e plotë për licencë dhe datës së vendimit përfundimtar;

30. **“Ekuivalentët me kohë të plotë”** nënkupton totali i orëve, duke përfshirë orët shtesë, të punuara në një punë gjatë një viti, i pjesëtuar me numrin mesatar të orëve të punuara në vit në një punë me kohë të plotë;

31. **“Kantier manovrimi, depot”** nënkupton një territor hekurudhor ose një pjesë e tij, i pajisur me një numër vijash hekurudhore ose pajisjesh të tjera, që përdoren për operacionet e renditjes së mjeteve hekurudhore, duke përfshirë dhe ndërrimin e vijave hekurudhore.

Neni 3

Mbledhja dhe dorëzimi i të dhënave

1. Deri më 31 dhjetor të çdo viti, administratorët e infrastrukturës hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore dhe poseduesit e impianteve të shërbimit, informojnë te ARRH-ja, të dhënat e specifikuara në pyetësinë e përfshirë në shtojcë, në lidhje me vitin paraprak.

2. ARRH-ja i paraqet Komisionit të dhënat në lidhje me transportin hekurudhor në territorin shqiptar.

3. Kur një sipërmarrje hekurudhore operon në më shumë se një shtet, ajo duhet t’u ofrojë autoriteteve kombëtare të dhëna të ndara për secilin shtet në të cilin operon.

4. ARRH-ja merr të dhënat e nevojshme nga një kombinim i burimeve të mëposhtme:

a) anketat e detyrueshme;

b) të dhëna administrative, duke përfshirë të dhënat e mbledhura nga zyrat statistikore dhe autoritetet e tjera;

c) vlerësime statistikore, duke shpjeguar metodat e përdorura;

ç) të dhënat e ofruara nga organizatat përkatëse të industrisë ose palët e tjera të interesuara; dhe

d) studime *ad hoc*.

Subjektet e mësipërme, që mbajnë të dhënat përkatëse duhet t'i japin ato në kohën kur kërkohen.

5. Informacioni duhet mbledhur dhe përgatitur sipas materialeve udhëzuese metodologjike të sjella nga Komisioni në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave.

6. ARRH-ja, mbi bazën e të dhënave që mbledh, plotëson dhe dërgon formularin elektronik të pyetësorit që është i disponueshëm në faqen e internetit të Komisionit.

7. ARRH-ja respekton konfidencialitetin tregtar të informacionit që i ofrohet asaj.

Neni 4

Dispozitat kalimtare

1. Mbledhja e të dhënave duhet të sigurojë informacionin sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcë, duke filluar nga viti 2027. Kur identifikohen vështirësi të konsiderueshme në mbledhjen e të dhënave ose ka shqetësime, në lidhje me rëndësinë ose domosdoshmërinë e kategorive të caktuara të të dhënave, duhet të kërkohet vlerësim për përshtatjen e shtojcës.

2. Kur, gjatë periudhës kalimtare, nuk mund të jepen të dhënat sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcë, dhënia e tyre bëhet në format të ngjashëm duke treguar mospërputhjet kur i dorëzojnë të dhënat.

SHTOJCË

PYETËSORI I MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR

Informacion mbi sfondin

Shteti anëtar:

☐ BE ☐ BG ☐ CZ ☐ DK ☐ DE ☐ EE ☐ IE ☐ EL ☐ ES ☐ FR ☐ HR ☐ IT ☐ CY ☐ LV ☐ LT ☐ MT ☐ LU ☐ AT ☐ PL ☐ PT ☐ RO ☐ SI ☐ SK ☐ FI ☐ SE ☐ MB ☐ JO

Periudha e informimit: / / — / /

Autoriteti përgjegjës:

Adresa e email-it për kontakt:

Meqë monedha kombëtare nuk është euro, duhet të përdoret kursi mesatar i këmbimit gjatë periudhës raportuese për të kthyer vlerat monetare nga monedha lekë në euro. Kursi i këmbimit i përdorur duhet të tregohet më poshtë.

1 = , EUR

Pyetjet e shënuara me një yll (*) janë opsionale.

Kur detyrimet e informimit në këtë shtojcë i referohen sipërmarrjeve hekurudhore, ato nuk zbatohen për sipërmarrjet hekurudhore të cilat operojnë vetëm shërbime urbane, periferike ose rajonale në rrjete të pavarura lokale dhe rajonale, siç përcaktohet në nenin 3, pika 2, të Kodit.

1. Tarifimi i infrastrukturës

1.1 Tarifat mesatare të përdorimit të infrastrukturës (TPI) për tren–km për kategori të ndryshme trenash

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenave në përdorim. Kur mesataret aritmetike nuk mund të llogariten, mund të jepet një vlerësim i TPI-ve të kategorive të ndryshme të trenave. Metoda e përdorur për të llogaritur ose vlerësuar TPI-të duhet të shpjegohet në kuadratin e paragrafit 1.5, ⁽¹⁾më poshtë.

Kategoria e trenit (vetëm nëse është në përdorim)	Tarifa e përdorimit të infrastrukturës, duke përfshirë shtesat (euro/tren–km)
Shërbimet për udhëtarët:	
Tren udhëtarësh që ofron shërbime periferike dhe rajonale	,
Tren udhëtarësh që ofron shërbime konvencionale në distanca të gjata	,

Tren udhëtarësh që ofron shërbime me shpejtësi të lartë në linja të dedikuara me shpejtësi të lartë	☐ ☐ ☐ ☐
Shërbimet e transportit të mallrave:	
Tren mallrash me peshë bruto 1000 ton	☐ ☐ ☐ ☐
Tren mallrash me kapacitet 1600 ton bruto	☐ ☐ ☐ ☐
Tren mallrash me peshë bruto 6 000 ton	☐ ☐ ☐ ☐

1.2 Të ardhurat e administratorëve të infrastrukturës nga tarifat e infrastrukturës, stacioneve dhe terminaleve

Vetëm tarifat e mbledhura nga administratorët e infrastrukturës duhet të informohen. Këto përfshijnë tarifat e mbledhura për mjediset e stacioneve dhe terminalët e mallrave në pronësi ose të menaxhuara nga administratorët e infrastrukturës.

Të ardhurat (mijë euro)	
Shërbimet për udhëtarët:	
Të ardhurat totale nga tarifat e aksesit në shina, duke përfshirë rritjet e çmimeve	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Të ardhurat totale nga tarifat e stacionit	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
<i>Nga të cilat:</i>	
Tarifat e stacionit për trenat periferikë dhe rajonalë (*)	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Tarifat e stacionit për trenat konvencionalë të distancave të gjata dhe me shpejtësi të lartë (*)	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Tarifa të tjera të mbledhura nga operatorët e trenave të udhëtarëve	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Shërbimet e transportit të mallrave:	
Të ardhurat totale nga tarifat e aksesit në shina, duke përfshirë rritjet e çmimeve	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Të ardhurat totale nga tarifat e terminalit të mallrave	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Tarifa të tjera të mbledhura nga operatorët e trenave të mallrave	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
Të ardhurat totale të mbledhura nga menaxherët e infrastrukturës	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

1.3 Karakteristikat kryesore të marrëveshjeve kontraktuale, të lidhura në përputhje me nenin 30, pikës 2, të Kodit

Administrator i infrastrukturës (emri)	Gjatësia e rrjetit të mbuluar (km)	Data e fillimit	Data e mbarimit	A janë rënë dakord për treguesit e performancës? ⁽²⁾ Nëse po, ju lutem specifikoni	Kompensimi total nga shteti (mijëra euro)	Ekzistenca e një organi monitorues të kontratës? Nëse po, ju lutem specifikoni (emri)
				☐ PO ☐ JO	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	☐ PO ☐ JO
				☐ PO ☐ JO	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	☐ PO ☐ JO
				☐ PO ☐ JO	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	☐ PO ☐ JO
				☐ PO ☐ JO	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	☐ PO ☐ JO
				☐ PO ☐ JO	☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	☐ PO ☐ JO

1.4 Ulja e zhurmës

A ka rregulla të detyrueshme (qoftë në fuqi ose që do të futen) që i detyrojnë operatorët hekurudhorë dhe/ose administratorët e infrastrukturës të marrin masa për të zvogëluar ekspozimin e popullsisë ndaj zhurmës hekurudhore? Këto masa mund të përfshijnë kufizime në vëllimet e trafikut, barriera zhurmash ose TPI të diferencuara për shkak të zhurmës që synojnë përsheptimin e pajisjes së vagonëve të mallrave me blloqe frenash “pa zhurmë”.

☐ PO ☐ JO

Nëse po, ju lutemi specifikoni:

1.5 Komete shitesë (*):

Mund të shtohen komente të mëtejshme mbi pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Shpjegoni se si janë llogaritur TPI-të mesatare për tren–km në tabelën 1.1, duke përfshirë edhe cilët komponentë të tarifave përfshihen.
- Specifikoni nëse aplikohen rritje çmimesh përveç TPI-ve të raportuara.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Tregoni nëse janë aplikuar TPI-të e diferencuara të ERTMS.⁽³⁾

2. Ndarja e kapaciteteve

2.1 Seksionet e mbingarkuara të infrastrukturës

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me seksionet e mbingarkuara, siç përcaktohet në nenin 47, pikës 1, të Kodit, në lidhje me situatën në fund të periudhës raportuese.

Gjatësia totale e binarëve të prekur nga mbingarkesa (km)	□□□□□□□□
Nga të cilat:	
Linja të dedikuara me shpejtësi të lartë (km)	□□□□□□□□
Korridoret hekurudhore të mallrave (km)	□□□□□□□□
Numri i nyjave të mbingarkuara	□□□

2.2 Shërbime prioritare

Jepni renditjen (1 që do të thotë prioriteti më i lartë) e shërbimeve hekurudhore kur duhet të përcaktohen përparësitë për ndarjen e kapacitetit të infrastrukturës, p.sh. brenda procesit të planifikimit dhe koordinimit dhe në rastet e kufizimeve ose shqetësimeve të përkohshme të kapacitetit. Nëse ndonjë nga shërbimet e listuara nuk është i përshtatshëm për rregullat e prioritetit, ju lutemi vendosni një kryq (‘x’) në kuti.

☐ Shërbimet e ofruara sipas detyrimeve të shërbimit publik (PSO);	
☐ Shërbime vendase me shpejtësi të lartë;	
☐ Shërbime të tjera të brendshme për pasagjerë;	
☐ Shërbimet ndërkombëtare të pasagjerëve;	
☐ Shërbime transporti të brendshëm;	
☐ Shërbime ndërkombëtare të transportit të mallrave;	
☐ Të tjera	Ju lutem specifikoni:

2.3. Shpërndarje të suksesshme dhe të refuzuara të itinerareve për shërbime të ndryshme

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenave në përdorim. Ju lutemi të jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me situatën pas proceseve të planifikimit dhe koordinimit të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të Kodit.

Shërbim	Itinerare të planifikuara të trenave		Itinerare treni ad hoc	
	Shpërndarje të suksesshme të itinerarëve (numër)	Shpërndarjet e refuzuara të itinerarëve (numër)	Shpërndarje të suksesshme të itinerarëve (numër)	Shpërndarjet e refuzuara të itinerarëve të (numër)
Shërbimet totale	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□

për udhëtarë:				
Vendase, periferike dhe rajonale	☐	☐	☐	☐
Transporti konvencional vendas në distanca të gjata	☐	☐	☐	☐
Shpejtësi e lartë vendase	☐	☐	☐	☐
Ndërkombëtar	☐	☐	☐	☐
Shërbime totale të transportit të mallrave:	☐	☐	☐	☐
Transporti vendas	☐	☐	☐	☐
Transport ndërkombëtar	☐	☐	☐	☐
Nga të cilat:				
Itineraret e ndara nga qendrat e vetme të korridoreve hekurudhore të mallrave	☐	☐	☐	☐

2.4 Komete shitesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Jepni një përshkrim të shkurtër të kriterëve të përparësisë, të përdorura nga administratorët e infrastrukturës për ndarjen e itinerareve, në lidhje me rrethanat në të cilat zbatohen këto kriterë, p.sh. brenda procesit të planifikimit dhe koordinimit dhe në rast të kufizimit ose shqetësimit të përkohshëm të kapacitetit.
- Specifikoni nëse është përdorur tarifa e mungesës së kapacitetit të përcaktuar në nenin 32, pika 4 të Kodit.
- Specifikoni nëse janë përgatitur dhe zbatuar planet e rritjes së kapaciteteve të përcaktuar në nenin 51 të Kodit.

3. Shpenzimet për infrastrukturën

Tregoni shpenzimet e bëra gjatë periudhës raportuese nga administratorët kryesorë të infrastrukturës hekurudhore dhe nga pronarët e tjerë të stacioneve dhe terminaleve të mallrave. Në tregjet e fragmentuara, fushëveprimi i raportimit mund të kufizohet në shpenzimet e pronarëve të stacioneve kryesore dhe terminaleve të mallrave.⁽⁴⁾ Për stacionet dhe terminalët intermodale, përfshini vetëm pjesën e shpenzimeve që lidhen me transportin hekurudhor.

3.1 Përmbledhje e shpenzimeve për infrastrukturën hekurudhore

	(mijë euro)			
	Mirëmbajtje	Rinovimet	Përmirësime	Infrastrukturë e re
Linjat konvencionale	☐	☐	☐	☐
Linja të dedikuara me shpejtësi të lartë	☐	☐	☐	☐
Stacionet kryesore	☐	☐	☐	☐

Terminalet kryesore të mallrave				
Shpenzimet totale				

3.2 Burimi i financimit për shpenzimet për komponentë të ndryshëm të infrastrukturës⁽⁵⁾

	(mijë euro)		
	Fondet publike	Fondet e BE-së	Fondet e veta
Infrastruktura ekzistuese, duke përfshirë stacionet kryesore dhe terminalët e mallrave			
Infrastrukturë e re			
Linja konvencionale dhe të dedikuara me shpejtësi të lartë			
Stacionet kryesore			
Terminalet kryesore të mallrave			
Shpenzimet totale			

3.3 Komete shitesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Bëni referencë në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Infrastrukturës, në përputhje me nenin 10, pikës 2, të Kodit.

4. Të ardhurat dhe vëllimet e trafikut

4.1 Të ardhurat dhe vëllimet e shërbimeve të udhëtarëve dhe mallrave

Për të siguruar që vëllimi i shërbimeve dhe të ardhurat e paraqitura përputhen, në këtë tabelë duhet të jepen vetëm të ardhurat e gjeneruara nga trafiku hekurudhor në territorin shqiptar. Mund të përdoren vlerësimet statistikore, nëse është e nevojshme. Nëse statistikatat zyrtare mbi vëllimet e trafikut nuk janë ende të disponueshme, mund të jepen vlera paraprake dhe më pas të rregullohen në një datë të mëvonshme.

Shërbimet për udhëtarët:	
Të ardhurat totale të ndërmarrjeve hekurudhore nga shërbimet e transportit (mijëra euro)	
Vëllimi total i shërbimeve (mijë tren-km)	
Vëllimi total i shërbimeve (milion pasagjerë-km)	
Vëllimi i shërbimeve të brendshme (milion pasagjerë-km)	
Vëllimi i shërbimeve ndërkombëtare (milion pasagjerë-km)	
Vëllimi i shërbimeve të tranzitit (*) (milion pasagjerë-km)	
Të ardhurat nga dhe vëllimet e PSO-së dhe shërbimeve tregtare	
Shërbimet PSO:	
Të ardhurat nga tarifat (mijëra euro)	
Kompensimi i PSO-së (mijë euro) ⁽⁶⁾	
Vëllimi i shërbimeve (milion pasagjerë-km) ⁽⁷⁾	
Shërbime komerciale:	
Të ardhurat nga tarifat (mijëra euro)	
Vëllimi i shërbimeve (milion pasagjerë-km)	
Shërbimet e transportit të mallrave:	

Të ardhurat totale të ndërmarrjeve hekurudhore nga shërbimet e transportit (mijëra euro)	□□□□□□□□□□
Vëllimi total i shërbimeve (mijë tren-km)	□□□□□□□□□□
Vëllimi total i shërbimeve (milion ton-km)	□□□□□□□□□□
Vëllimi i shërbimeve vendase (milion ton-km)	□□□□□□□□□□
Vëllimi i shërbimeve ndërkombëtare (milion ton-km)	□□□□□□□□□□
Vëllimi i shërbimeve të tranzitit (*) (milion ton-km)	□□□□□□□□□□

4.2 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Tregoni nëse vlerat e dhëna për të ardhurat e gjeneruara nga trafiku hekurudhor në territorin kombëtar janë shifra të raportuara apo vlerësime. Kur janë përdorur mostra ose vlerësime, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Specifikoni nëse ka pasur ndonjë boshllëk ose mospërputhje në të dhënat e futura.

5. Cilësia e shërbimeve hekurudhore

Tabelat duhet të plotësohen vetëm për kategoritë e trenit në përdorim.

5.1 Saktësia dhe anulimet e shërbimeve të udhëtarëve

Shërbimet për udhëtarët:	Numri total i shërbimeve	Numri i trenave që mbërrijnë në kohë (vonesë prej 5 minutash ose më pak)	Numri i shërbimeve të anuluar
Shërbime periferike dhe rajonale	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□
Shërbime konvencionale në distanca të gjata dhe me shpejtësi të lartë	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□

5.2 Përpikmëria dhe anulimet e shërbimeve të transportit të mallrave ⁽⁸⁾

Shërbimet e transportit të mallrave:	Numri total i shërbimeve	Numri i trenave që mbërrijnë në kohë (vonesë prej 15 minutash ose më pak)	Numri i shërbimeve të anuluar
Shërbimet brendshme	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□
Shërbime ndërkombëtare	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□

5.3 Shpejtësia mesatare e orarit të shërbimeve të mallrave (*)

Shërbimet e transportit të mallrave:	Shpejtësia mesatare e orarit (km/orë)
Shërbimet e brendshme	□□□
Shërbime ndërkombëtare	□□□

5.4 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Shpjegoni se si është matur ‘vonesa’ e një treni (p.sh. vetëm në ndalesën e fundit ose si mesatare mbi të gjitha ndalesat e planifikuara).
- Jepni referenca për raportet e performancës dhe anketat e kënaqësisë të publikuara nga bordi i menaxhimit të korridorit hekurudhor të mallrave në të cilën përfshihemi⁽⁹⁾.

- Jepni referenca për çdo anketë tjetër mbi cilësinë e shërbimeve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve që është kryer kohët e fundit.

6. Detyrimet e shërbimit publik (PSO)

6.1 Vëllimi i shërbimeve dhe kompensimi i paguar për shërbimet e ofruara sipas PSO-ve në segmente të ndryshme të tregut

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenit në përdorim.

	Vëllimi i shërbimeve (milion udhëtarë–km)			Vëllimi i shërbimeve (mijë tren–km)	Kompensimi PSO (mijë euro) ⁽¹⁰⁾
	Totali	Nga të cilat:			
		Ofertuar në mënyrë konkurruese	I dhënë drejtpërdrejt		
Shërbimet totale PSO					
Nga të cilat:					
Periferike dhe rajonale					
Distancë e gjatë konvencionale					
Shpejtësi e lartë					
Nga të cilat:					
Shërbimet ndërkombëtare të ofruara në kuadër të PSO-ve					

6.2 Qasja në mjetet lëvizëse në kontekstin e shërbimeve PSO

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me secilën kontratë PSO të dhënë gjatë periudhës raportuese.

	Përshkrimi (rajonet ose linjat e mbuluara)	Kohëzgjatja (vite)	Vëllimi i kontratës (mijë tren-km/vit)	Operatori (emri)	A u ofrua kontrata në mënyrë konkurruese?	Marrëveshjet për sigurimin e mjeteve lëvizëse	
						I përcaktuar në specifikimet e tenderit?	Përshkrimi ⁽¹¹⁾
1.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
2.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
3.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
...					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	

6.3 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

7. Shkalla e hapjes së tregut

Renditni sipërmarrjet hekurudhore që kanë një pjesë tregu prej 1% ose më shumë. Kur ka më shumë se dhjetë sipërmarrje me një pjesë tregu prej 1% ose më shumë, renditni vetëm 10

më të mëdhatë. Pjesa e tregut që mbajnë sipërmarrjet e tjera hekurudhore mund të jepet si total nën ‘Të tjera’.

Nëse për arsye të konfidencialitetit tregtar emri i një sipërmarrjeje hekurudhore nuk mund të tregohet, ju lutemi përdorni pseudonime, p.sh. ‘RU 1’, ‘RU 2’. Nëse kjo nuk do të ishte e mjaftueshme për të zgjidhur çështjet e konfidencialitetit, pjesët e tregut të sipërmarrjes hekurudhore, përveç asaj të sipërmarrjes kryesore ose ekzistuese hekurudhore, mund të grupohen më tej.

7.1 Tregu i udhëtarëve – shërbimet PSO

Sipërmarrja hekurudhore (emri ose pseudonimi)	Pjesa e tregut të shërbimeve PSO (përqindje) ⁽¹²⁾
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.2 Tregu i udhëtarëve – shërbime tregtare

Sipërmarrja hekurudhore (emri ose pseudonimi)	Pjesa e tregut të shërbimeve komerciale (përqindje) ⁽¹³⁾
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.3 Tregu i mallrave

Sipërmarrja hekurudhore (emri ose pseudonimi)	Pjesa e tregut të shërbimeve të transportit të mallrave (përqindje) ⁽¹⁴⁾
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.4 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Tregoni nëse ndonjë sipërmarrje e re hekurudhore e madhe ka hyrë në tregun e pasagjerëve ose të mallrave gjatë periudhës së raportimit.

8. Shkalla e harmonizimit dhe zhvillimet legislative (*)

Informacioni mbi shkallën e harmonizimit ligjor është tashmë në dispozicion të Komisionit, pasi kemi njoftuar Komisionin kur e kemi transpozuar legjislacionin. Ky seksion u lejon vendeve të tjera të komentojnë mbi çdo çështje të pazgjidhur që lidhet me tregun hekurudhor të BE-së ose me zhvillimin e ligjeve kombëtare mbi hekurudhat.

8.1. Komente shtesë (*):

9. Licencimi

9.1 Numri i licencave të lëshuara për sipërmarrjet hekurudhore⁽¹⁵⁾

Numri i licencave aktive në fillim të periudhës raportuese (A)	□□□□
Numri i licencave të pezulluara ose të revokuara gjatë periudhës raportuese ⁽¹⁶⁾ (B)	□□□□
Numri i licencave të dhëna gjatë periudhës raportuese (C)	□□□□
Numri i licencave aktive në fund të periudhës raportuese (A – B + C)	□□□□
Numri i licencave pasive në fund të periudhës raportuese	□□□□

9.2 Tarifat dhe koha e nevojshme për marrjen e një licence

Tarifa mesatare për të marrë një licencë (euro)	□□□□□□□
Koha mesatare për marrjen e një licence (ditë kalendarike)	□□□

9.3. Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

10. Punësimi dhe kushtet sociale

10.1 Punonjësit në sektorin hekurudhor sipas gjinisë dhe grup-moshës

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me situatën në fund të periudhës raportuese. Kur ndonjë nga sipërmarrjet ofron shërbime edhe për sektorë të tjerë përveç sektorit hekurudhor, numri i punonjësve mund të deklarohet bazuar në një vlerësim të përqindjes së totalit të punonjësve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të lidhura me hekurudhën.

	Totali (ekuivalentët me kohë të plotë)	Burra (%)	Gratë (%)	< 30 vjet (%)	30–50 vjet (%)	> 50 vjet (%)
Stafi total i sipërmarrjeve hekurudhore ekzistuese ose sipërmarrjeve të tjera kryesore ⁽¹⁷⁾	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Nga të cilat: makinitët e trenave	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Totali i stafit të sipërmarrjeve të tjera hekurudhore	□□□□□□□					
Nga të cilat: makinitët e trenave	□□□□□□□					
Stafi total i administratorëve kryesorë të infrastrukturës	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Stafi total i administratorëve të tjerë të infrastrukturës	□□□□□□□					
Stafi i kompanive të tjera që ofrojnë shërbime të lidhura me transportin	□□□□□□□					

shërbejnë 10 000–25 000 udhëtarëve në ditë						☐						☐
Stacione që u shërbejnë 1 000–10 000 udhëtarëve në ditë	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Stacione që u shërbejnë më pak se 1000 udhëtarëve në ditë	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Terminalet e mallrave	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Depot	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Pajisjet e mirëmbajtjes	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Pajisjet portuale detare dhe të brendshme të lidhura me shërbimet hekurudhore	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Impiante furnizimi me karburant	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐

11.2 Numri i ankesave që lidhen me objektet e shërbimit

Deklaroni numrin e ankesave të bëra në lidhje me aksesin në ambiente, nivelin e tarifave ose cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ankesat që aktualisht po përpunohen nga organi rregullator	☐
Vendimet e marra mbi ankesat gjatë periudhës raportuese	☐

11.3 Përshkrimi i ankesave:

Jepni një përshkrim të shkurtër dhe të përgjithshëm të rasteve kryesore (deri në dhjetë) për të cilat është marrë një vendim gjatë periudhës raportuese. Tregoni nëse ndonjë nga ankesat ka ngritur pyetje në lidhje me interpretimin e *acquis* evropiane të hekurudhave dhe përshkruani veprimet e propozuara për të korrigjuar situatën.

11.4 Komente shtesë (*):

Shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Specifikoni nëse Autoriteti Rregullator Hekurudhor është konsultuar në ndonjë rast.

¹ Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e qasjeve të mundshme që mund të ndërmerren gjatë llogaritjes së TPI-ve, të dhënat e ofruara në këtë tabelë nga shtete të ndryshme anëtare nuk do të jenë domosdoshmërisht të krahasueshme dhe do të jenë kryesisht të dobishme për monitorimin e trendeve brenda secilit shtet anëtar.

² Siç specifikohet në nenin 31, pika 2, shkronja “c”, e Kodit.

³ Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor.

⁴ Për qëllimet e këtij pyetësori, stacionet që u shërbejnë mbi 10 000 udhëtarëve në ditë jave konsiderohen si ‘stacione kryesore’, dhe терминаlet e mallrave me një kapacitet mbi 100 000 kontejnerë në vit ose mbi 1 milion ton në vit konsiderohen si ‘terminale kryesore mallrash’.

⁵ Totali i shpenzimeve të raportuara në tabelat 3.1 dhe 3.2 duhet të jetë përgjithësisht afërsisht i barabartë.

⁶ Shifra e raportuar këtu duhet të jetë e njëjtë me atë të raportuar në tabelën 6.1. Pagesat e koncesionit nga një operator për një autoritet publik duhet të trajtohen si kompensime ‘negative’ të PSO-së.

⁷ Shifra e raportuar këtu duhet të jetë e njëjtë me atë të raportuar në tabelën 6.1.

⁸ Vetëm për shërbimet e planifikuara.

⁹ Rregullorja në lidhje me një rrjet hekurudhor evropian për transportin konkurrues të mallrave.

¹⁰ Pagesat e koncesionit nga një operator për autoritetin publik duhet të trajtohen si kompensim ‘negativ’ i PSO-së.

¹¹ Marrëveshje e dakordësuar për sigurimin e materialit lëvizës për secilën kontratë, p.sh. në pronësi, të subvencionuar ose të garantuar nga autoriteti kontraktues; e ofruar nga ndërmarrja hekurudhore ose e marrë me

qira.

¹² Në bazë të udhëtarëve-km të ofruara në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.

¹³ Në bazë të udhëtarëve-km të ofruara në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.

¹⁴ Në bazë të ton-km të dhëna në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.

¹⁵ Nuk do të jetë e detyruar plotësimi i këtij seksioni pasi informacioni mbi licencat e sipërmarrjeve hekurudhore të jetë i disponueshëm për të gjitha shtetet në Bazën e të Dhënave të Agjencisë Evropiane të Hekurudhave për Ndërveprimin dhe Sigurinë (Eradis).

¹⁶ Duke përjashtuar licencat e riaktivizuara gjatë periudhës së raportimit.

¹⁷ Shtrirja e raportimit duhet të mbulojë të paktën 50% të tregut (bazuar në udhëtarë-km dhe ton-km).

¹⁸ Kur ata nuk përfshihen në stafin e sipërmarrjes hekurudhore ose të administratorit të infrastrukturës të dhënë më sipër.

¹⁹ $A + B = 100\%$.

²⁰ Shtrirja e raportimit duhet të mbulojë të paktën 50% të tregut (bazuar në udhëtarë-km dhe ton-km).

²¹ Duke përfshirë administratorët e infrastrukturës së integruar dhe bashkimin e shoqërive.

²² Duke përfshirë sipërmarrjet hekurudhore joaktive dhe administratorët e infrastrukturës, të cilët janë pjesë e bashkimit të shoqërive.

²³ Qeverisje kombëtare, rajonale ose lokale.